



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.36

2005

27 maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9374 datë 21.4.2005	Për ndihmën shtetërore	1311
Ligj nr.9375 datë 21.4.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001.....	1319
Ligj nr.9376 datë 21.4.2005	Për sportin	1322
Udhëzim i MD nr.2945, datë 27.5.2005	Për caktimin e datës së konkurrimit, rregullave të funksionimit të Komisionit të Kualifikimit të Noterëve, si dhe të kriterëve dhe procedurave të organizimit dhe të shpalljes së rezultateve të provimit.....	1335

LIGJ
Nr. 9374, datë 21.4.2005

PËR NDIHMËN SHTETËRORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i procedurave, sipas të cilave lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare, që përmbajnë dispozita për ndihmën shtetërore.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve, si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore ose entet, që veprojnë në emër të shtetit dhe që japin një përfitim për ndërmarrje të veçanta, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për ndihmën shtetërore të dhënë në sektorët e bujqësisë dhe të peshkimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Dhënës të ndihmës shtetërore" (në vazhdim "dhënës") janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër, që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

2. "Ndërmarrje" është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.

3. "Ndërmarrje të vogla e të mesme" janë ndërmarrjet, që kanë jo më shumë se 250 punonjës dhe një xhiro vjetore jo më të madhe se 40 milionë euro ose një llogari të bilancit jo më të madhe se 27 milionë euro dhe që nuk janë të zotëruara në një masë më të madhe se 25 për qind të kapitalit ose të së drejtës së votës nga një ose disa ndërmarrje, që nuk cilësohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

4. "Produkt" është çdo mall i shitur ose i blerë apo çdo shërbim i ofruar ose i hedhur në treg nga ndërmarrjet.

5. "Përfitues i ndihmës shtetërore" është çdo ndërmarrje ose individ, që merr ndihmë shtetërore.

6. "Skemë e ndihmës shtetërore" është çdo akt normativ, mbi bazën e të cilit, në formë të përgjithshme dhe pa pasur nevojën e akteve të tjera zbatuese, mund t'u jepet ndihmë ndërmarrjeve.

7. "Ndihmë individuale" është çdo ndihmë, që i jepet një përfituesi të ndihmës shtetërore.

8. "Intensiteti i ndihmës shtetërore" është ekuivalenti i grantit, i shprehur në përqindje të totalit të kostove të pranueshme ose të shpenzimeve të përfituesit të ndihmës shtetërore.

9. "Ndihmë e paligjshme" është çdo ndihmë shtetërore, që jepet dhe zbatohet në kundërshtim me këtë ligj ose në kundërshtim me vendimet e marra nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

10. "Ndërmarrje në vështirësi" është ndërmarrja, e cila nuk është e aftë që nëpërmjet burimeve të veta ose nëpërmjet fondeve, që ajo mund të përfitojë nga aksionerët ose kreditorët e saj, të pakësojë humbjet, të cilat, pa ndërhyrjen e dhënësve të ndihmës, do ta detyrojnë atë brenda një periudhe, afatshkurtër ose afatmesme, të largohet nga veprimtaria ekonomike.

11. "Ndihmë shtetërore për rastet e shpëtimit" është një mbështetje financiare për një ndërmarrje në vështirësi, për një periudhë kohore, gjatë së cilës duhet të përgatitet plani i ristrukturimit ose i likuidimit.

12. "Ndihmë shtetërore për ristrukturim" është një mbështetje financiare, që jepet për ristrukturimin e veprimtarisë së një ndërmarrjeje dhe për sigurimin, brenda një periudhe të arsyeshme, të rentabilitetit afatgjatë të saj.

13. Ndihmë për sektorë të ndjeshëm" është ndihma për ata sektorë, ku kapaciteti i prodhimit është më i madh se kërkesa në treg për produktin në fjalë.

14. "Ndihmë rajonale" është ndihma që jepet për zhvillimin e zonave të prapambetura në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4

Ndalimi i ndihmës shtetërore

1. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloji forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.

2. Format e ndihmës shtetërore përfshijnë kryesisht:

- a) grantet dhe subvencionet;
- b) përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;
- c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;
- ç) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;
- d) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta;
- dh) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
- e) uljen e çmimit të produkteve të ofruara, shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;
- ë) zmadhimin e kapitalit shtetëror të ndërmarrjet ose ndryshimin e vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat, që vepron në kushte ekonomike normale.

3. Çdo ndihmë e ndaluar është e rimbursueshme.

Neni 5

Ndihma për eksport

Ndalohet ndihma që është e lidhur drejtpërdrejt me kuotat e eksportit dhe me shpenzimet korrente, të lidhura me veprimtarinë e eksportit.

Neni 6
Ndihma për sektorët e ndjeshëm

Ndihma për sektorët e ndjeshëm është e ndaluar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me vendim të Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

Neni 7
Ndihma shtetërore e lejueshme

Ndhimë shtetërore e lejueshme është:

- a) ndihma me karakter social, që jepet për individë, nëse kjo ndihmë është dhënë pa krijuar diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë;
- b) ndihma që jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga gjendja e jashtëzakonshme.

Neni 8
Ndihma "De minimis"

Ndihma "De minimis" është e lejueshme nëse ajo, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin jepet, nuk kalon vlerën prej 100 mijë eurosh, për një periudhë prej tre vjetësh dhe, në të njëjtën kohë, nuk jepet për veprimtaritë e eksportit ose nuk kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt atyre të importuara.

Neni 9
Ndihma për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Ndihma për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme lejohet:

- a) në rastin e ndihmës për investime, të prekshme dhe të paprekshme, kur intensiteti nuk kalon 15 për qind të kostove shtesë të pranueshme të investimit;
- b) në rastin e shërbimeve këshillimore ndihma nuk kalon 50 për qind të kostove të këtyre shërbimeve, të cilat nuk duhet të jenë një veprimtari e vazhdueshme ose periodike dhe as të jenë të lidhura me shpenzimet e zakonshme të veprimtarisë;
- c) për pjesëmarrjen për herë të parë në panairë dhe ekspozita, kur ndihma nuk kalon 50 për qind të kostove shtesë për marrjen me qira, ngritjen ose funksionimin e standave.

Neni 10
Ndihma për punësim

Ndihma për punësim lejohet kur:

- a) intensiteti i ndihmës nuk kalon 15 për qind të kostos së pagave, për një periudhë 2-vjeçare, për vendet e reja të punës në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që punësojnë deri në 50 punonjës dhe 7,5 për qind në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që punësojnë 51 deri në 250 punonjës;
- b) intensiteti maksimal i ndihmës mund të rritet kur kontributi i përfituesit të saj është mbi 25 për qind;
- c) ndihma jepet për punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave në vështirësi dhe intensiteti i saj nuk kalon:
 - i) 60 për qind të kostos së pagave, për personat me aftësi të kufizuar;
 - ii) 50 për qind të kostos së pagave, për personat në vështirësi.

Neni 11

Ndihma për trajnim

Ndihma për trajnimin e veçantë dhe trajnimin e përgjithshëm lejohet:

- a) në rastin e trajnimit të veçantë, kur intensiteti i saj nuk kalon 25 për qind të kostove të trajnimit për ndërmarrjet e mëdha dhe 35 për qind për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- b) në rastin e trajnimit të përgjithshëm, kur intensiteti i saj nuk kalon 50 për qind të kostove të trajnimit për ndërmarrjet e mëdha dhe 70 për qind për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Neni 12

Ndihma për kërkim dhe zhvillim

Ndihma për kërkim dhe zhvillim mund të jepet, nëse intensiteti i saj, i llogaritur mbi bazën e kostove të pranueshme të projektit, nuk kalon:

- a) 100 për qind për kërkimin bazë, me kusht që rezultatet e kërkimit të shfrytëzohen nga të gjithë mbi baza jodiskriminuese dhe sipas normave të tregut;
- b) 60 për qind për kërkimin industrial;
- c) 35 për qind për kërkimin parakonkurrues, përfshirë transformimin në projekte të rezultateve të kërkimit industrial, konceptimin ose projektimin e produkteve të reja, të ndryshuara ose të përmirësuara, zhvillimin e një modeli, i cili nuk është i përdorshëm në kushte tregtare.

Neni 13

Ndihma shtetërore e lejueshme

Ndihma shtetërore mund të lejohet nëse ajo:

- a) nxit zhvillimin ekonomik të rajoneve të Republikës së Shqipërisë, të karakterizuara nga standarde jetese shumë të ulëta, ose të zonave ku ka papunësi serioze;
- b) nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë ose jepet për të mënjanuar gjendje të rënda në ekonominë e vendit;
- c) lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;
- ç) nxit zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë;
- d) është në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose me aktet e tjera normative të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 14

Ndihma rajonale

1. Ndihma rajonale mund të lejohet, nëse ajo mbulon deri në 50 për qind të vlerës së investimit fillestar ose të kostos së pagave të punonjëse për dy vjet për vendet e reja të punës. Investimi dhe vendet e reja të punës duhet të ruhen për një periudhë prej pesë vjetësh. Në çdo rast, intesiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75 për qind të vlerës.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale.

Neni 15

Ndihma shtetërore për ndërmarrjet në vështirësi

1. Ndihma për shpëtimin e një ndërmarrjeje në vështirësi mund të lejohet nëse nuk kalon vlerën e nevojshme dhe jepet në formën e garancive shtetërore ose të huave me çmimin e tregut, për një periudhë 6-mujore, gjatë së cilës është përgatitur likuidimi ose një plan ristrukturimi.

2. Ndhimja për ristrukturim mund të lejohet nëse mbështetet në një plan ristrukturimi, i cili parashikon masa ristrukturimi, që sigurojnë një rentabilitet afatgjatë të ndërmarrjes.

3. Në rastin e skemave të ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim, plani i ristrukturimit miratohet nga dhënësi i ndihmës dhe i paraqitet Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

4. Ndhimja për shpëtim dhe/ose ristrukturim lejohet një herë në 10 vjet.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim.

KREU II STRUKTURAT E KONTROLLIT TË NDIHMËS SHTETËRORE

Neni 16

Komisioni i Ndhimës Shtetërore

1. Komisioni i Ndhimës Shtetërore (në vazhdim “Komisioni”) është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni është i pavaruar në kryerjen e funksioneve të veta.

2. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, me kryetar ministrin që mbulon çështjet e ekonomisë. Anëtarët e tjerë emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, të ministrit që mbulon çështjet e ekonomisë, të Ministrit të Drejtësisë dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Anëtarët e Komisionit emërohen për një periudhë 4-vjeçare dhe duhet të jenë profesionistë e me përvojë në fushën e ekonomisë.

4. Këshilli i Ministrave përcakton masën e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit dhe burimin e mbulimit.

Neni 17

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

a) vlerëson dhe autorizon skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale, në bazë të propozimeve të Drejtorisë së Ndhimës Shtetërore;

b) urdhëron kthimin e ndihmës së paligjshme;

c) mbikëqyr përdorimin e ndihmës shtetërore dhe rezultatin ekonomik të përftuar nga dhënia e saj;

ç) merr vendime të tjera, në bazë të procedurave të këtij ligji;

d) nxjerr udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij ligji;

dh) harton, me ndihmën e Drejtorisë së Ndhimës Shtetërore, raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe e paraqet atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili ia përçjell Komisionit Europian;

e) bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë, në kuadër të marrëveshjeve dhe angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Drejtorja e Ndhimës Shtetërore

Drejtorja e Ndhimës Shtetërore në ministrinë që mbulon çështjet e ekonomisë (në vazhdim “Drejtorja”), si strukturë administrative për kontrollin e ndihmës shtetërore, në veçanti, kryen këto detyra:

a) grumbullon, përpunon dhe mbikëqyr të dhënat për ndihmën shtetërore;

b) merr njoftimet dhe përgatit vendimet e Komisionit;

c) merr raportet nga dhënësi i ndihmës për mënyrën e zbatimit dhe rezultatin ekonomik, të arritur nga përdorimi i kësaj ndihme;

ç) mban regjistrin e ndihmës shtetërore;

d) merr vendime, në bazë të dispozitave të këtij ligji;

- dh) harton udhëzime dhe i paraqet për miratim pranë Komisionit;
- e) përgatit raportin vjetor për ndihmat shtetërore;
- ë) bashkëpunon me institucionet e huaja kompetente dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë për çështjet e ndihmës shtetërore.

KREU III PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Neni 19

Parimi i përgjithshëm

Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, strukturat e ndihmës shtetërore, gjatë ushtrimit të funksioneve, zbatojnë Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 20

Njoftimi i ndihmës

1. Dhënësi i ndihmës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, njofton Drejtorinë për çdo plan për dhënien e ndihmës.
2. Drejtoria, brenda 15 ditëve pune, njofton dhënësin e ndihmës për marrjen e këtij njoftimi.
3. Në njoftim, dhënësi i ndihmës duhet të japë të gjitha të dhënat e nevojshme për marrjen e një vendimi, sipas nenit 22 të këtij ligji.
4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për procedurat dhe formën e njoftimit.

Neni 21

Pezullimi i ndihmës

Përveç rasteve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, ndihma nuk vihet në zbatim përpara se Komisioni të marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

Neni 22

Procedurat e shqyrtimit dhe vendimet

1. Drejtoria shqyrton menjëherë njoftimin dhe nëse është i plotë, ia paraqet Komisionit për vlerësim.
2. Komisioni merr vendim të miratojë, me ose pa kushte, ose të mos miratojë ndihmën e njoftuar.
3. Vendimet e Komisionit merren brenda 60 ditëve kalendarike. Afati fillon të nesërmen e ditës së dorëzimit të njoftimit të plotë.
4. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 23

Propozime për masa të përshtatshme

Për skemat e ndihmës, të miratuara në mbështetje të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji dhe skemat e ndihmës, që kanë filluar të zbatohen përpara hyrjes në fuqi të tij, Komisioni mund të propozojë masa për përshtatjen e tyre me dispozitat e ligjit.

Neni 24

Kërkesa për informacion shtesë

1. Kur Drejtoria e gjykon jo të plotë informacionin e siguruar nga njoftimi i një plani për

ndihmë, sipas nenit 20 të këtij ligji, ajo kërkon nga dhënësi i ndihmës informacionin e nevojshëm shtesë. Drejtorja, brenda 15 ditëve pune, njofton dhënësin e ndihmës për marrjen e përgjigjes.

2. Kur dhënësi i ndihmës nuk e siguron informacionin e kërkuar ose jep informacion jo të plotë, brenda periudhës së përcaktuar, Komisioni merr vendim, në bazë të informacionit në zotërim.

Neni 25

Procedura për ndihmën e paligjshme

Kur Komisioni ose Drejtorja ka informacion për një ndihmë që mendohet e paligjshme, i kërkohet dhënësit të ndihmës të paraqesë informacionin e nevojshëm për shqyrtim.

Neni 26

Vendimi për pezullimin e ndihmës së paligjshme

Komisioni mund të marrë një vendim, me anë të të cilit i kërkon dhënësit të ndihmës pezullimin e zbatimit të çdo ndihme të paligjshme, derisa Komisioni të ketë marrë një vendim për lejueshmërinë e kësaj ndihme.

Neni 27

Kthimi i ndihmës

1. Në rastet e ndihmës së paligjshme, kur merret një vendim për moslejimin e saj, Komisioni urdhëron kthimin e ndihmës nga përfituesi.

2. Ndhima që kthehet duhet të përfshijë edhe interesin, me një normë të përshtatshme. Interesi paguhet nga data në të cilën ndihma e paligjshme është në dispozicion të përfituesit, deri në datën e kthimit të saj.

Neni 28

Ekzekutimi i kthimit

1. Vendimi për kthimin e ndihmës së paligjshme përbën titull ekzekutiv.

2. Vlera e kthyer e ndihmës, së bashku me interesin, depozitohen në buxhetin e dhënësit të ndihmës.

Neni 29

Komunikimi i vendimeve

Vendimet e marra nga Komisioni, në përputhje me këtë ligj, i komunikohen dhënësit të ndihmës.

Neni 30

Ankimi

1. Kundër vendimeve të Komisionit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimeve të Komisionit.

Neni 31

Publikimi i vendimeve

Vendimet e marra nga komisioni botohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 32
Raportet vjetore

1. Dhënësit e ndihmës detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë Drejtorisë raporte vjetore për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna.

2. Brenda datës 30 qershor, Komisioni paraqet pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor të vitit pararendës për skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna.

Neni 33
Sekreti profesional

Komisioni, Drejtorja dhe dhënësi i ndihmës, nëpunësit e tyre dhe vartës të tjerë, përfshirë ekspertë të caktuar nga Komisioni, janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional të informacioneve, që ata kanë arritur të marrin gjatë zbatimit të procedurave të këtij ligji.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34
Ngritja e strukturave të ndihmës shtetërore

1. Komisioni i Ndihmës Shtetërore e fillon ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj një muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Deri në ngritjen e Komisionit, procedurat në zbatim të këtij ligji, përveç atyre vendimmarrëse, kryhen nga Drejtorja e Ndihmës Shtetërore në ministrinë që mbulon çështjet e ekonomisë.

Neni 35
Fuqia prapavepruese

1. Ngarkohen të gjithë dhënësit e ndihmës që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të raportojnë pranë Drejtorisë për të gjitha skemat ekzistuese të ndihmës.

2. Nëse një skemë ekzistuese e ndihmës nuk raportohet brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohen dispozitat për ndihmën e paligjshme. Kthimi i ndihmës do të bëhet që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 36
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregulloret e përcaktuara në nenet 14, 15 dhe 20.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2006.

Shpallur me dekretin nr.4564, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 9375, datë 21.4.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8321, DATË 2.4.1998 “PËR
POLICINË E BURGJEVE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8757, DATË 26.3.2001**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) merr masa për shoqërimin dhe sigurimin e ruajtjes fizike të të paraburgosurve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale, të urdhëruara nga gjykata ose prokurori, si dhe shoqëron të dënuarit gjatë transferimeve, në lejet speciale dhe në lëvizjet jashtë institucionit;”.

2. Pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje:

“e) kontrollon për sende të ndaluara mjediset e brendshme dhe të jashtme, si dhe personat që hyjnë në regjimin e burgut;

ë) Policia e Burgjeve, në përputhje me urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Drejtësisë, kryen edhe detyra të tjera për garantimin e rendit, për paprekshmërinë e objekteve dhe regjimin e lëvizjeve në institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjala “trupa” zëvendësohet me fjalën “punonjësit”.

2. Pikat 3, 4 dhe 5 shfuqizohen.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Detyrat funksionale

Funksionet e punonjësve të Policisë së Burgjeve janë:

- a) Drejtor i Drejtorisë së Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
- b) shef sektori në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve;
- c) specialist i policisë në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve;
- ç) shef i policisë në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- d) specialist i regjimeve në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- dh) specialist i efektivit të policisë në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- e) specialist i shërbimit të informacionit në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Neni 4

Paragrafi i tretë i nenit 9 shfuqizohet.

Neni 5

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Koha e punës dhe e pushimit

Koha javore e punës dhe e pushimit, si dhe pushimi vjetor për punonjësit e Policisë së Burgjeve njësohen me ato të nëpunësve të tjerë të administratës publike. Kur për arsye pune dhe shërbimi, pushimi vjetor nuk jepet brenda vitit, punonjësi ka të drejtën e kryerjes së tij jo më vonë se muaji mars i vitit pasardhës. Në të kundërt, bëhet kompensimi në vlerë, sikurse edhe për mbikohën e punës dhe të shërbimit, gjatë kohës javore të punës, në ditët e pushimit ose në festat zyrtare.”.

Neni 6

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i gjashtë ndryshohet si më poshtë:

“Për gradimin e punonjësve të rolit bazë e të mesëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, funksionon komisioni këshillimor, përbërja dhe organizimi i të cilit caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”.

2. Pas paragrafit të gjashtë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për gradimin e punonjësve të rolit të lartë dhe madhor, pranë Ministrit të Drejtësisë funksionon komisioni këshillimor, përbërja dhe organizimi i të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 7

Në nenin 12, pas fjalëve “kriterëve të tjera përkatëse” shtohen fjalët “të përcaktuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit.””.

Neni 8

Në paragrafin e dytë të nenit 14, fjalët “sipas shkronjave “ç”, “d” dhe “dh”” zëvendësohen me fjalët “sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e””.

Neni 9

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë të pikës 1, fjala “Qortim” zëvendësohet me fjalën “Vërejtje”.

2. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për secilën nga masat disiplinore të mësipërme zbatohen kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Disiplinës të Policisë së Burgjeve, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.”.

Neni 10

Pas nenit 17 shtohen nenet 17/1 dhe 17/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1
Lirimi nga detyra

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra në rastet kur:
- a) ka mbushur moshën për pension;
 - b) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj, me ose pa vendim të komisionit mjekësor;
 - c) me kërkesë të tij, pasi ka plotësuar detyrimet sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - ç) për arsye të ristrukturimit dhe shkurtimeve të funksionit organik.
2. Në rastet kur punonjësi lirohet nga detyra, sipas shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, kur ai merr riaftësimin shëndetësor, ose kur krijohen vende dhe funksione të reja, ai gëzon të drejtën e kërkesës dhe të përzgjedhjes me përparësi për t’u punësuar, në mbështetje të formimit, kualifikimit dhe vjetërsisë që kishte në shërbim në Policinë e Burgjeve përpara lirimit nga detyra.”.

Neni 17/2
Largimi nga detyra

- Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra në rastet kur:
- a) është pranuar në punë në kundërshtim me kriteret e parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre;
 - b) shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat e disiplinës dhe të shërbimit pa u shlyer masat disiplinore të dhëna më parë;
 - c) është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - ç) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 ditë rresht pa shkaqe të arsyeshme.”.

Neni 11

Në paragrafin e parë të nenit 18 fjalët “nga eprori i drejtpërdrejtë” zëvendësohen me fjalët “në bazë të Rregullores së Disiplinës të Policisë së Burgjeve, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.”.

Neni 12

Në nenin 18/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:
- “6. Për dhënien e masës disiplinore, për punonjësin e rolit bazë, ngrihet Komisioni Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Përbërja dhe funksionimi i këtij Komisioni caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”.
2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:
- “7. Për dhënien e masës disiplinore, për punonjësin e rolit të mesëm dhe të lartë, si dhe për masën e largimit nga detyra të punonjësit të rolit bazë, ngrihet Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë. Përbërja dhe funksionimi i këtij Komisioni caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 13

- Pika 3 e nenit 18/2 ndryshohet si më poshtë:
- “3. Masat disiplinore “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim” shlyhen me kalimin e 6 muajve nga data e dhënies së tyre.
- Masat e tjera shlyhen me kalimin e 1 viti nga data e dhënies së tyre, me përjashtim të masës “largim nga detyra”.

Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes llogariten nga data që vendimi i titullarit ka marrë formë të prerë.”.

Neni 14

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Punonjësit e administratës civile të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4565, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 9376, datë 21.4.2005

PËR SPORTIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Europiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë.

2. Përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrore e vendore në fushën e sporteve.

3. Përcaktimi i bazave të përgjithshme dhe ligjore të organizimit dhe zhvillimit të sportit.

4. Përcaktimi i marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe shtetit e institucioneve të pushtetit vendor.

5. Të shërbejë si mbështetje ligjore, financiare dhe organizative, për funksionimin e institucioneve dhe të organizatave sportive, publike e private.

Neni 2 Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të funksionimit dhe të organizimit të sportit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Sport” është tërësia e veprimeve psiko-fizike, që synojnë zhvillimin e ushtruesve, argëtimin, edukimin, ruajtjen dhe forcimin e shëndetit, përmirësimin e mirëqenies së gjithanshme të tyre dhe arritjen e suksesit në garat sportive.

2. “Veprimtari sportive” është procesi i fitimit, mbajtjes dhe përmbushjes së mjeshtërive, kërkesave dhe kompetencës në sport.

3. “Garë sportive” është veprimtaria, e cila zhvillohet për përcaktimin e sportistëve dhe të skuadrave më të mira, në përputhje me kërkesat ligjore, me rregullat e procedurës së konkurrimit, të vendosura nga federatat sportive dhe të rregulloreve të vendosura nga organizatorët e garave.

4. “Sportist” është individ, ushtrues i një sporti në formë të ndryshme, i anëtarësuar në një organizatë sportive.

5. “Specialist i sportit” është një punonjës i sportit, i cili ka fituar një diplomë edukimi të sportit apo një certifikatë të përputhshme ose diplomë të kualifikimit profesional të edukimit të sportit ose certifikatë të përputhshme kualifikimi profesional.

6. “Organizata sportive” janë Komiteti Olimpik Shqiptar, federatat, klubet sportive dhe shoqatat, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.

7. “Federatë sportive” është person juridik privat, që krijohet në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive, që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar.

8. “Shoqatë sportive” është person juridik privat, që krijohet nga anëtarët, që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

9. “Shoqëri sportive” është një person juridik privat, që krijohet dhe funksionon në formën e shoqërisë tregtare, që ushtron veprimtari sportive me qëllime fitimprurëse, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi.

10. “Klub sportiv” është person juridik, që ushtron veprimtari sportive në një sport të caktuar.

11. “Objekt sportiv” është send i paluajtshëm, i ndërtuar në përputhje me kushtet e nevojshme për zhvillimin e një apo disa sporteve, në bazë të rregullave teknike, të miratuara nga federata kombëtare e sportit përkatës.

12. “Doping në sport” nënkupton administrimin nga sportistët ose përdorimin prej tyre të klasifikimeve farmakologjike të agjentëve doping.

13. “Sporti për të gjithë” përfaqëson një kompleks veprimtarish për praktikimin e lirë të ushtrimeve fizike, në një mjedis tërësisht të sigurt, të organizuar ose të pavarur, në mënyrë individuale ose në grup.

14. “Fair play” nënkupton lojën e ndershme dhe korrekte.

Neni 4 Parimet bazë të funksionimit të sportit në Republikën e Shqipërisë

Parimet bazë të sportit janë:

- a) parimi i barazisë, si një e drejtë e çdo shtetasi për t’u marrë me sport;
- b) parimi i lojës së ndershme dhe korrekte, i udhëhequr nga idealet olimpike dhe parimet e etikës sportive;

c) parimi i sigurisë, që ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarive sportive në një mjedis të sigurt.

Neni 5

1. Të ushtruarit e sportit është një e drejtë e të gjithë shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Askush nuk mund të privohet nga kjo e drejtë pa shkak të mbështetur në ligj.

2. Nuk përbëjnë shkelje të së drejtës për të ushtruar sportin rastet, kur kufizimet për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive, përcaktohen në rregulloret e organizimit të tyre.

3. Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, gjendja ekonomike ose shoqërore.

Neni 6

1. Sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.

2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe njësitë e qeverisjes vendore ngarkohen për të krijuar kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara.

3. Institucionet arsimore publike ose private në të gjitha nivelet nxisin dhe financojnë krijimin e organizatave sportive të nxënësve dhe/ose studentëve.

KREU II SHTETI DHE SPORTI

Neni 7

1. Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari publike.

2. Shteti nxit sportin për të gjithë dhe mbështet pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.

3. Shteti nxit dhe mbështet përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmon nëpërmjet sportit integrimin e tyre në jetën shoqërore.

4. Shteti mbështet organizatat sportive dhe subjektet sponsorizuese të veprimtarive sportive, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale.

5. Ndihmat në materiale dhe pajisje sportive, për organizatat sportive shqiptare, të cilat vijnë nga institucionet sportive ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit, përjashtohen nga detyrimet doganore.

6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive, bashkëpunon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion dhe financon ndërtimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

2. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit dhe strategjitë përkatëse për zhvillimin e tij, krijon institucionin përgjegjës për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive, që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

KREU III KËSHILLI KOMBËTAR I SPORTIT

Neni 9

1. Pranë Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve funksionon Këshilli Kombëtar i Sportit.
2. Këshilli Kombëtar i Sportit është një organ këshillimor, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave të shtetit për sportin.
3. Përbërja strukturore dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Sportit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përcakton anëtarët e Këshillit Kombëtar të Sportit dhe miraton përbërjen dhe Rregulloren e Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Kombëtar të Sportit.

KREU IV ORGANIZATAT SPORTIVE

Neni 10

Organizatave sportive janë:

- a) Komiteti Olimpik Shqiptar;
- b) federatat sportive;
- c) shoqatat sportive;
- ç) shoqëritë sportive;
- d) klubet sportive.

Neni 11

Komiteti Olimpik Shqiptar

1. Komiteti Olimpik Shqiptar është person juridik, që themelohet dhe funksionon si shoqatë sportive dhe që e ushtron veprimtarinë në mbështetje të legjislacionit shqiptar në fuqi, të Kartës Olimpike dhe në përputhje me statutin e tij, të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Lëvizja olimpike drejtohet dhe bashkërendohet nga Komiteti Olimpik Shqiptar.
3. Shteti njih vetëm Komitetin Olimpik Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të marrë atributet e këtij Komiteti.

Neni 12

Komiteti Olimpik Shqiptar bashkërendon fondet e veta me ato të pushtetit qendror e vendor në zbatim të programeve, si më poshtë:

- a) programi i edukimit olimpik;
- b) programi rinor i lëvizjes olimpike;
- c) programi i zhvillimit rajonal të lëvizjes olimpike;
- ç) programi i përgatitjes dhe pjesëmarrjes së sportistëve më të mirë të vendit në Lojërat Olimpike dhe në garat e tjera olimpike, ndërkombëtare dhe rajonale.

Neni 13

1. Në Komitetin Olimpik Shqiptar aderojnë federatat shqiptare dhe organizata të tjera sportive, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti.

2. Vendimet dhe veprimtaritë e Komitetit Olimpik Shqiptar i njoftohen Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 14

Federatat sportive

1. Federatat sportive pas titullit të përkatësisë, duhet të shënojnë emërtimin “Shqiptare” në titullin e tyre.

2. Të drejtën për të përfituar emërtimin “Federatë shqiptare” e një sporti të caktuar e gëzon ajo organizatë sportive, e cila krijohet me nismën e shumicës së thjeshtë të organizatave sportive të atij sporti, që kanë pranuar emërtimin dhe statutin e federatës së miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Pas miratimit të statudit, ky grupim kërkon regjistrimin e federatës përkatëse në gjykatën kompetente.

3. Federatat shqiptare gëzojnë të drejtën për t’u anëtarësuar në organizata të tjera sportive të nivelit më të lartë, brenda dhe jashtë vendit.

4. Vendimet dhe veprimtaritë sportive të federatave sportive shqiptare i njoftohen Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 15

1. Shteti i delegon të drejtën e organizimit dhe të zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare, vetëm një federatë sportive, në një sport të caktuar.

2. Emërtimi “Federatë shqiptare” e një sporti i hiqet një organizatë sportive kur:

a) veprimtaria e saj nuk zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statut;

b) asambleja e përgjithshme e saj merr vendime antikushtetuese dhe të jashtëligjshme;

c) pushon së funksionuari, si rezultat i shpërbërjes së saj.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve revokon urdhrin për emërtimin “Federatë shqiptare” dhe kërkon në gjykatën kompetente shpërndarjen e saj.

Neni 16

1. Federatat shqiptare financohen nga shteti, nga fondet e dhëna në formë granti, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit dhe nga burime të tjera.

2. Delegimi i fondeve buxhetore, sipas përparësive, bëhet me propozimin e federatave dhe me miratimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në mbështetje të ligjit, mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e grantit të dhënë federatës shqiptare, si edhe veprimtarinë e saj me karakter publik.

4. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, krahas detyrave statutore, ka edhe këto detyra:

a) organizon kampionatin kombëtar dhe kupën e Shqipërisë dhe shpall “ekipin Kampion Kombëtar” dhe “ekipin fitues të Kupës së Shqipërisë” në sportin përkatës;

b) përdor simbolet e federatës ose autorizon përdorimin e tyre nga anëtarë të tjerë, për çdo qëllim;

c) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në federatat ndërkombëtare sportive;

ç) organizon ekipin kombëtar dhe merr pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose autorizon pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;

d) organizon në Republikën e Shqipërisë veprimtari sportive ndërkombëtare dhe jep leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj;

dh) përfaqëson atë sport në organizatat sportive kombëtare.

5. Asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të marrë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.

Neni 17

Shoqatat sportive

1. Shoqatat sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit dhe objekti i veprimtarisë së shoqatave sportive mbështeten në ligjet nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe nr.8789, datë 7.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

3. Shoqatat sportive kombëtare nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit përkatës.

4. Shoqatat sportive përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet granteve dhe nga burime të tjera.

Neni 18

Shoqëritë sportive

1. Shoqëritë sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit, si dhe objekti i veprimtarisë së shoqërive sportive mbështeten në legjislacionin për shoqëritë tregtare.

3. Shoqëritë sportive nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to, pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit që ushtrojnë.

4. Shoqëritë sportive përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet granteve dhe nga burime të tjera.

Neni 19

Klubet sportive

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë si shoqëri anonime, sipas dispozitave të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

2. Transformimi i klubeve sportive në shoqëri anonime miratohet nga Ministria e Ekonomisë, me kërkesë të organit të pushtetit qendror ose vendor, në varësi të të cilit është klubi sportiv. Ky transformim bëhet brenda një afati prej dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Klubi sportiv i transformuar në shoqëri anonime gëzon të drejtën e përparësisë së përdorimit të objekteve sportive të institucionit publik, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet tyre.

Neni 20

Në shoqëritë tregtare, me objekt ushtrimin e veprimtarisë sportive në një sport të caktuar, pjesa e kapitalit shtetëror ose paketa e aksioneve të zotëruara nga shteti mund të privatizohen nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar.

KREU V
DREJTËSIA SPORTIVE

Neni 21
Shqyrtimi administrativ

1. Federatat sportive krijojnë organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në statutin e tyre.

2. Organet e gjykimit disiplinor të federatave shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore a teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose atë të disiplinës.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo anëtar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente, në rast se vendimet e organeve drejtuese të federatës bien në kundërshtim me ligjin dhe me statutin e saj. Federatat bien dakord që, për zgjidhjen e këtyre konflikteve, përpara se t'i drejtohen gjykatës kompetente, me marrëveshje ndërmjet tyre, të ngrenë organe arbitrazhi, në zbatim të Kodit të Procedurës Civile.

KREU VI
SPORTISTI DHE SPECIALISTI NË SPORT

Neni 23

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet, në varësi të sportit që ushtron dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre.

2. Pjesëmarrja në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga kontrata e punës.

3. Transferimi i sportistit nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive, të miratuara nga federata shqiptare e atij sporti dhe nga ato ndërkombëtare.

Neni 24

1. Klubi sportiv detyrohet të punësojë vetëm specialistë të licencuar nga federata shqiptare e sportit përkatës.

2. Funksonet e specialistit sportiv mund t'i kryejë vetëm individi, i cili gëzon licencën profesionale, të lëshuar nga federata shqiptare e atij sporti. Klubet sportive, kur aktivizojnë specialistë të palicencuar, dënohen sipas sanksioneve të përcaktuara në rregulloret e veprimtarisë sportive.

Neni 25

1. Sportisti duhet të respektojë rregullat e federatës përkatëse kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, parimet etike të sportit dhe të lojës së ndershme, lojën e ndershme, kushtet e Konventës së Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë.

2. Specialisti i sportit drejton veprimtaritë sportive dhe i përcakton ato, duke pasur parasysh ngarkesën fizike, për një përdorim racional të sportit, për forcimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe arritjen e një mjeshtërie të lartë.

KREU VII SPORTI I NIVELIT TË LARTË

Neni 26

1. Federata shqiptare e një sporti të caktuar i propozon Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të shpërblejë me mjete financiare ose me mjete të tjera personat, të cilët arrijnë rezultate të cilësisë së lartë sportive.

2. Kriteret për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv dhe mënyrat e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII OBJEKTET SPORTIVE

Neni 27

1. Objektet sportive janë publike ose private.

2. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe për ndërtimin e objekteve të reja.

3. Objektet sportive private janë në pronësi të personave juridikë privatë.

4. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive. Objektet sportive në pronësi publike përdoren për të ofruar shërbime të nevojshme për sportin për të gjithë.

Neni 28

1. Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike, të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.

2. Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.

Neni 29

Organet shtetërore ose organizatat sportive, që i kanë në pronësi a përdorim këto objekte, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 30

1. E drejta e shfrytëzimit të mjedisit sportiv i takon administratorit të tij.

2. E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë së garës, që zhvillohet në mjedisin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.

3. Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale.

4. Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie a gare sportive nuk mund t'u vërë sportistëve, pjesëmarrës në këtë veprimtari a gare sportive, asnjë detyrim që cenon lirinë e tyre, qoftë atë të të shprehurit apo çdo lloj lirie tjetër individuale.

Neni 31

1. Ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qendror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”.

2. Objektet sportive jepen me koncesion apo privatizohen, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.

KREU IX E DREJTA E TRANSMETIMIT

Neni 32

Organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutet e tyre.

Neni 33

1. E drejta e transmetimit radioteleviziv të veprimtarive sportive të ekipeve kombëtare të Republikës së Shqipërisë, në rrugë ajrore, tokësore ose me çdo lloj mënyre tjetër transmetimi, rregullohet sipas nenit 77 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Transmetimi i informacionit nga operatorët e tjerë radiotelevizivë bëhet në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU X REKLAMAT DHE SPONSORIZIMET

Neni 34

Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjedisive sportive, ku zhvillojnë veprimtarinë ose garën sportive, për reklamën e shoqërive të ndryshme tregtare, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese me to.

Neni 35

1. Klubet sportive ose sportistët, për sportet individuale, në përputhje edhe me rregulloret e federatave përkatëse të sportit, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv, gjithmonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën dypalëshe të sponsorizimit ndërmjet klubit, federatës së sportit ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare.

2. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës përkatëse sportive dhe me aktet ligjore në fuqi.

KREU XI BURIMET FINANCIARE

Neni 36

1. Fondet e Buxhetit të Shtetit për sportin përcaktohen në Buxhetin vjetor të Shtetit.
2. Në fondet financiare për sportin përfshihen edhe burimet e pushtetit vendor, të organizatave sportive, të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit, si dhe financimet e dhëna nga federatat ndërkombëtare sportive ose nga ndonjë burim tjetër i ligjshëm.

Neni 37

Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit

Pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve krijohet Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nga të ardhurat, që sigurohen nga llotaritë sportive, sipas ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”. Përdorimi i Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit bëhet me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas udhëzimit të nxjerrë prej tij në zbatim të këtij ligji.

KREU XII VEPRIMTARITË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Neni 38

Organizimi i një gare sportive

1. Organizues të një gare sportive janë organizatat sportive ose institucionet e pushtetit qendror apo vendor.
2. Organizuesi i garës sportive duhet të njoftojë pushtetin vendor dhe organet e rendit në territorin administrativ ku do të zhvillohet kjo garë.

Neni 39

Pjesëmarrja në garat sportive ndërkombëtare

1. Sportistët dhe ekipet, që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në garat sportive ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e federatave përkatëse sportive, përdorin simbolin kombëtar.
2. Federatat sportive shqiptare përkatëse, ekipet dhe sportistët përfaqësues të organizatave sportive ndërkombëtare organizojnë pjesëmarrjen e ekipit kombëtar në garat sportive ndërkombëtare. Ato vënë në dijeni rregullisht Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për ecurinë e këtyre garave dhe parashikimet për to.

Neni 40

Organizimi i lojërave olimpike rajonale, garat finale botërore dhe kampionatet europiane dhe botërore

1. Lojërat olimpike dhe veprimtaritë me karakter olimpike organizohen nga Komiteti Olimpik Shqiptar.
2. Garat finale botërore dhe kampionati europian e ai botëror në Republikën e Shqipërisë organizohen nga federatat sportive, me mbështetjen e strukturave përgjegjëse të sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Organizimi i lojërave olimpike, i garave finale botërore dhe i kampionatit europian e atij botëror duhet të plotësojnë kërkesat e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe të federatave sportive ndërkombëtare.

KREU XIII
KONTROLLI MJEKËSOR DHE ANTIDOPINGU

Neni 41

1. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive është i ndaluar përdorimi i substancave doping.
2. Lista e substancave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
3. Çdo përdorim i dopingut dhe nxitja për përdorimin e tij dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga federatat përkatëse.

Neni 42

1. Veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë e drejton Komisioni Kombëtar Antidoping, i cili është një strukturë këshillimore e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pranë Qendrës Kërkimore Shkencore të Sportit. Komisioni Kombëtar Antidoping është në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Përbërja, funksionimi, të drejtat dhe detyrat e këtij Komisioni përcaktohen me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Komisioni Kombëtar Antidoping i rekomandon Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve marrjen e masave të parashikuara ndaj personave, që përdorin ose nxisin përdorimin e dopingut.
4. Federatat shqiptare të sportit pranojnë autoritetin e Komisionit Kombëtar Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre dhe dënimin e përdoruesve të dopingut. Ky detyrim përcaktohet në statutin e federatës.
5. Komisioni Kombëtar Antidoping dhe të gjitha organizatat sportive janë të detyruara të respektojnë antidopingun, të përcaktuar në dispozitat e Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9242, datë 17.6.2004.

Neni 43

1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në një federatë dhe të marrë pjesë në veprimtarinë sportive të organizuar prej saj pa paraqitur vërtetimin mjekësor, që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e anëtarësuar pajisen me kartelë mjekësore vetjake.
2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të specializuar, të paktën një herë në vit. Sporte të veçanta, për natyrën e veçantë të tyre, parashikojnë në rregulloret e funksionimit kontrole mjekësore më të shpeshta.
3. Me urdhër të përbashkët të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrit të Shëndetësisë përcaktohen kriteret dhe procedurat e kontrollit mjekësor sportiv.
4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative ose penale për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.

Neni 44

1. Organizatat sportive janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve, që marrin pjesë në veprimtaritë e tyre sportive.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve, që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Organizata sportive, që lejon pjesëmarrjen e sportistëve të pasiguar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KREU XIV
KUALIFIKIMI DHE KËRKIMI SHKENCOR

Neni 45

Shteti mbështet dhe financon kërkimin dhe kualifikimin shkencor në sport. Kualifikimi dhe kërkimi në sport realizohen nga institucionet shkencore të specializuara dhe nga çdo organizatë sportive.

Neni 46

1. Qendra Kërkimore e Sportit është institucioni shkencor, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Objekti kryesor i veprimtarisë së këtij institucioni është:

- a) realizimi i studimeve dhe i analizave shkencore në sport;
- b) kualifikimi i trajnerëve dhe i punonjësve shkencorë;
- c) kontrolli dhe vlerësimi i sportistëve cilësorë.

2. Mënyra e funksionimit të këtij institucioni përcaktohet në statutin e tij, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU XV
DHUNA NË SPORT

Neni 47

Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive ose/dhe ndaj spektatorëve.

Neni 48

1. Ndalohet mbajtja dhe përdorimi në objektet sportive, gjatë zhvillimit të veprimtarive, i fishekzjarreve dhe i armëve të të gjitha llojeve, si dhe përdorimi dhe tregtimi i pijeve alkoolike.

2. Personi, që merr pjesë në veprimtari sportive në cilësinë e gjyqtarit, është i paprekshëm. Ai është përfaqësues i federatës shqiptare të një sporti të caktuar.

Neni 49

1. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjedise sportive të hapura për spektatorët është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.

2. Rregullat për zbatimin e kësaj dispozite, në këshillim me organizatat sportive, përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në zbatim të nenit 58 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Neni 50

1. Veprimtarinë kundër dhunës e drejton Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, një strukturë me karakter këshillimor pranë Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Përbërja e funksionimi i këtij Komisioni dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport i rekomandon Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve marrjen e masave të parashikuara kundër personave, që përdorin ose nxisin përdorimin e dhunës.

3. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport dhe të gjitha organizatat sportive, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport, ku ka aderuar Republika e Shqipërisë.

KREU XVI KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 51

1. Shkelja e dispozitave detyruese të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga inspektorët e ngarkuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Shkelja e pikës 3 të nenit 5 përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet.

3. Shkelja e pikës 2 të nenit 19 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 1 000 000 lekë.

4. Shkelja e nenit 48 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

KREU XVII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 52

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të nenit 7 pika 6, nenit 9 pika 3, nenit 26 pika 2, nenit 46 pika 2 dhe nenit 50 pika 2, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 53

Ligji nr.8114, datë 28.3.1996 “Për sportin”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4566, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

UDHËZIM
Nr. 2945, datë 27.5.2005

PËR CAKTIMIN E DATËS SË KONKURRIMIT, RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT TË NOTERËVE, SI DHE TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË SHPALLJES SË REZULTATEVE TË PROVIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimi i kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit organizohet brenda afateve të parashikuara në nenin 3 dhe paragrafin i gjashtë të nenit 3/ç të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” (të ndryshuar).

2. Ministri i Drejtësisë me urdhër përcakton ditën, orën, vendin e zhvillimit të provimit, numrin e vendeve vakante, për të cilat do të konkurrohet sipas bashkive ku gjenden këto vende, afatet e paraqitjes së kërkesave për konkurrim, dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën, si dhe tarifën e pjesëmarrjes në provim. Urdhri del 15 ditë para ditës së organizimit të provimit të kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit.

3. Me daljen e urdhrit të parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, Drejtoria e Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë bën publikimin e njoftimit të ditës, orës, vendit të zhvillimit të provimit, numrit të vendeve vakante, për të cilat do të konkurrohet sipas bashkive ku gjenden këto vende, afatet e paraqitjes së kërkesave për konkurrim, dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën, në një prej televizioneve kombëtare dhe në dy prej gazetave me tirazh më të madh. Gjithashtu një kopje e këtij urdhri vendoset në një vend të dukshëm në hyrje të institucionit për të mundësuar njohjen e të interesuarve me përmbajtjen e tij. Në rast se kërkohet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, punonjësit e strukturave përgjegjëse për profesionet e lira, të cilët janë ngarkuar me informimin e të interesuarve, janë të detyruar t’u vënë në dispozicion një kopje të urdhrit dhe t’i sqarojnë e orientojnë, lidhur me kërkesat që duhen plotësuar dhe afatet përkatëse.

4. Për çdo rast të organizimit të provimit të kualifikimit për noterë pranë Ministrisë së Drejtësisë krijohet Komisioni i Kualifikimit të Noterëve. Komisioni ngrihet vetëm për një provim dhe ka për detyrë të mbikëqyrë procedurat e provimit, të përcaktojë listën emërore të personave që morën pjesë në provim, si dhe pikët me të cilat është vlerësuar çdo pjesëmarrës.

Përbërja e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të Noterëve dhe pagesa e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 3 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”(të ndryshuar).

Në ndihmë të Komisionit të Kualifikimit të Noterëve funksionon edhe sekretaria teknike e tij, përbërja e së cilës përcaktohet në urdhrin për përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të Noterëve.

5. Pas daljes së urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, që përcakton datën e organizimit të provimit, personat që dëshirojnë të marrin pjesë në provimin e kualifikimit të noterëve do të paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë një kërkesë, si dhe dokumentacionin që vërteton se i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga legjislacioni për të marrë pjesë në provim.

Kërkesa duhet të paraqitet jo më vonë se 3 ditë përpara ditës së organizimit të provimit.

Në rastin kur kërkuesi ka qenë asistent, kërkesa duhet të përcaktojë se do të konkurrohet vetëm për vendin vakant në territorin e dhomës së noterisë, anëtar i së cilës është noteri pranë të cilit ka qëndruar asistent.

Në rastin kur kërkuesi plotëson kushtet ligjore që e përjashtojnë nga qëndrimi si asistent, kërkesa mund të përcaktojë se kërkuesi do të konkurrojë në vendet vakante të jo më shumë se dy dhomave noteriale.

6. Drejtoria e Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë organizon punën për regjistrimin e kërkesave dhe informon të interesuarit lidhur me kushtet e organizimit të provimit, dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje, si dhe për tarifën e provimit dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.

Në rast se kërkuesi i plotëson të gjitha kushtet e parashikuara për të marrë pjesë në provim, ai regjistrohet në një listë, e cila afishohet në një vend të dukshëm në hyrje të Ministrisë së Drejtësisë, ditën që ka përfunduar afati i paraqitjes së kërkesave. Lista duhet të përmbajë emrat e personave që do të konkurrojnë, dhomat për vendet vakante për të cilat do të konkurrojnë dhe duhet të jetë e nënshkruar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë.

Personat, të cilëve nuk u është pranuar kërkesa dhe nuk janë regjistruar si më sipër, kanë të drejtë t'i drejtohen me ankesë Ministrisë së Drejtësisë brenda 2 ditëve nga dita e mbarimit të afatit të parashikuar për paraqitjen e kërkesës.

7. Konkurrentët do të paraqiten për të marrë pjesë në provim në ditën, orën dhe vendin e caktuar në urdhrin e Ministrisë.

Identifikimi i konkurrentëve, kryerja e detyrave të parashikuara nga ky udhëzim gjatë kohës që zhvillohet provimi dhe mbikëqyrja e konkurrentëve deri në dorëzimin e përgjigjeve të tezës, kryhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit, që janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe nga anëtarët e sekretarisë teknike. Anëtarët e tjerë kanë të drejtë të jenë të pranishëm, nëse e çmojnë të arsyeshme.

Identifikimi i tyre do të bëhet në bazë të një dokumenti identifikimi personal të vlefshëm dhe me fotografi, i cili mund të jetë letërnjoftim, pasaportë ose certifikatë personale me fotografi.

8. Pyetjet e provimit do t'i referohen legjislacionit që zbatohet në ushtrimin e profesionit të noterit. Pyetjet, si dhe pikët për secilën pyetje, do të përmbahen në tri teza që mbyllen në zarfe të veçanta. Vlerësimi maksimal i tezës së provimit do të jetë 100 pikë, të cilat do të jenë rezultat i shumës së pikëve për çdo pyetje.

Tezat hartohen në Ministrinë e Drejtësisë nga anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Noterëve jo më herët se një ditë para provimit të kualifikimit dhe nuk duhet t'u bëhen të ditura personave të tjerë.

Të gjitha zarfet duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Noterëve. Komisioni i Kualifikimit të Noterëve ditën e testimit në prani të konkurrentëve përzgjedh me short njërin prej zarfeve. Zarf i duhet të jetë i mbyllur dhe i nënshkruar, në të kundërtën teza në të është e pavlefshme dhe zëvendësohet me një zarf tjetër të mbyllur. Pas përzgjedhjes zarfi hapet nga Komisioni dhe teza e përzgjedhur u lexohet publikisht konkurrentëve nga Kryetari i Komisionit.

9. Përpara fillimit të provimit, pasi është kryer identifikimi, konkurrentëve u shpërndahen fletët në të cilat ata do të shtjellojnë tezën e provimit, si dhe materiale të tjera të nevojshme për kryerjen e provimit. Fletët duhet të jenë të vulosura me vulën e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa fleta e parë në të cilën jepen gjeneralitetet e konkurrentit është e sekretuar. Gjithashtu përpara fillimit të provimit konkurrentët vihen në dijeni për kohën brenda së cilës duhet të përfundojnë dhënien e përgjigjeve, udhëzohen që të mos komunikojnë mes tyre ose me persona jashtë ambientit ku organizohet provimi, të mbajnë qetësi, të mos konsultohen me libra ose materiale të tjera të shkruara, si dhe u jepen udhëzime e sqarime të tjera të rastit, e vihen në dijeni për pasojat, në rast se nuk i respektojnë kërkesat e parashtruara.

Konkurenti që gjatë provimit nuk i respekton udhëzimet e dhëna, njoftohet të ndërpresë provimin dhe konsiderohet i skualifikuar. Ky person barazohet me ata që nuk e kanë marrë minimumin e nevojshëm të pikëve të parashikuara me ligj për t'u kualifikuar. Në këtë rast, përkrah emrit të personit bëhet shënimi "Skualifikohet" dhe vihet në dijeni kryetari i Komisionit të Kualifikimit, i cili nënshkruan poshtë shënimin dhe bën pasqyrimin përkatës në procesverbalin e provimit.

10. Pas përfundimit të kohës së caktuar për provimin, mblidhen përgjigjet e tezës së konkurrentëve dhe nëse është rast, bëhen shënimet përkatëse sipas parashikimeve të mësipërme. Më pas ato i dorëzohen kryetarit të Komisionit ose një anëtarit të ngarkuar prej tij për të filluar procesi i vlerësimit.

11. Për përcaktimin e listës emërore të personave që morën pjesë në provim, si dhe të pikëve me të cilat është vlerësuar çdo pjesëmarrës, Komisioni merr vendim me shumicë votash, kur janë të pranishëm kryetari dhe jo më pak se 2 anëtarë. Kur numri i anëtarëve është çift dhe votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit të Komisionit është vendimtare.

Për marrjen e vendimit mbahet procesverbal, i cili hartohet në 4 kopje nga një prej anëtarëve të Komisionit të caktuar nga kryetari dhe që është përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.

Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, përfshirë edhe ata që nuk pajtohen me vendimin.

Anëtarit, që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, e nënshkruan procesverbalin me shënimin “Nuk pajtohem me vendimin. Bashkëlidhur paraqes mendimin tim”.

Ky anëtar paraqet veçmas, me shkrim, mendimin e tij. Ky dokument hartohet në numër të njëjtë kopjesh me numrin e kopjeve të procesverbalit dhe pasi nënshkruhet nga hartuesi, çdo kopje e tij i bashkëlidhet një kopjeje të procesverbalit.

Në rast se anëtarit i Komisionit, i cili ka mendim të kundërt me shumicën, nuk përgatit mendimin e tij me shkrim si më lart, kundërshtimi i tij konsiderohet i paqenë.

Në rast se një nga anëtarët e Komisionit nuk merr pjesë në veprimtarinë e Komisionit ose nuk respekton kërkesat e parashikuara në këtë udhëzim, Ministri i Drejtësisë urdhëron mosdhënien e pagesës së caktuar në urdhrin e krijimit të Komisionit.

12. Komisioni i Kualifikimit bën vlerësimin dhe llogarit shumën e pikëve të fituara. Rezultatet e çdo konkurrenti pasqyrohen në një listë, e cila i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur nga Komisioni, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

Lista duhet të hartohet në një kopje më shumë se numri i kopjeve të procesverbalit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Një kopje e saj afishohet brenda 3 ditëve nga dita e kryerjes së provimit në një vend të dukshëm në hyrje të Ministrisë së Drejtësisë.

13. Nga konkurrentët që kanë marrë 80 ose më shumë pikë, do të përcaktohen fitues të gjithë ata që kokurrojnë për vendet e liruara nga prindërit ose bashkëshortët, pavarësisht se mund të kenë marrë më pak pikë se konkurrentët e tjerë për të njëjtin vend.

Në rast se për vendin e prindit ose të bashkëshortit ka dy konkurrentë të kësaj kategorie, do të përcaktohet fitues konkurrenti që ka marrë më shumë pikë. Në rast se do të kenë pikë të barabarta, fitues do të jetë ai që ka më shumë vite pune në profesion, dhe kur kjo përvojë është e njëjtë, fituesi përcaktohet me short.

Për vendet e tjera, nga grupi i konkurrentëve që kanë marrë 80 ose më tepër pikë, do të konsiderohet fitues konkurrenti i cili ka konkurruar për atë vend dhe kur janë më shumë konkurrentë se vende vakant, atëherë fituesi do të përcaktohet duke ndjekur rregullin sipas të cilit kush ka më shumë pikë do të jetë fitues. Ky rregull do të ndiqet deri në plotësimin e të gjitha vendeve. Në këtë kategori do të përfshihet edhe konkurrenti i cili ka konkurruar për vendin e prindit ose të bashkëshortit, dhe sipas kriteve të paragrafit të mësipërm nuk është fitues.

Në rast se dy ose më tepër konkurrentë, sipas paragrafit të mësipërm, kanë marrë pikë të barabarta, fitues do të jetë ai që ka më shumë vite pune në profesion, dhe kur kjo përvojë është e njëjtë, fituesi përcaktohet me short.

Në rastet kur konkurrenti fitues përcaktohet me short, shorti organizohet nga 3 përfaqësues të Drejtorisë së Profesioneve të Lira në Ministrinë e Drejtësisë brenda 2 ditëve nga dita e shpalljes së listës së rezultateve të provimit në prani të dy konkurrentëve. Rezultati i shortit fiksohet në një procesverbal të veçantë, i cili nënshkruhet nga personat që e organizojnë atë dhe nga dy konkurrentët. Në rast se njëri prej tyre refuzon të nënshkruajë, në procesverbal bëhet shënimi “refuzon të nënshkruajë”.

14. Struktura përgjegjëse për profesionin e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 2 ditëve nga dita e shpalljes së listës së rezultateve të provimit, mbi bazën e kriterëve të parashikuara në pikën 13 të këtij udhëzimi, si dhe të rezultateve të çdo konkurrenti, harton një listë me emrat e personave fitues dhe me vendet në të cilat ata kanë fituar, sipas dhomave të noterisë.

Ministri i Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga dita e daljes së rezultateve të provimit të kualifikimit të noterëve, nxjerr urdhrin e dhënies së lejes së profesionit për çdo konkurrent fitues. Urdhri përcakton personin të cilit i jepet leja për ushtrimin e profesionit të noterit, njësinë vendore ku do ta ushtrojë profesionin dhe detyrimin e strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë për të siguruar zbatimin e këtij urdhri. Një ditë pas nxjerrjes së urdhrave për dhënien e lejes së profesionit, Ministri i Drejtësisë shpall listën e konkurrentëve që janë pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të noterit, e cila afishohet në një vend të dukshëm në hyrje të Ministrisë së Drejtësisë dhe zë vendin e shpalljes së rezultateve të provimit.

Ky afishim është i barazvlefshëm me njoftimin e të interesuarve për efekt të afateve të ankimit administrativ e gjyqësor të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

15. Në rast se, pas përfundimit të procedurave të provimit, kanë mbetur ende vende vakant, riorganizohet procesi i provimit, duke filluar me shpalljen publike të vendeve vakant sipas parashikimeve të ligjit, si dhe duke ndjekur parashikimet e këtij udhëzimi.

16. Kundër urdhrin të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, përsëritjes së konkurrimit për vendet vakante, si dhe të procedurës së zhvillimit të provimit të kualifikimit, konkurrenti i interesuar, në bazë të nenit 9 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditësh nga data e afishimit të listës së konkurrentëve që janë pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të noterit.

17. Procesverbali, përgjigjet e tezës të dhëna nga konkurrentët, urdhrat e Ministrit të Drejtësisë, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër që krijohet dhe i përket procesit të publikimit të vendeve vakant, organizimit të provimit, shpalljes së rezultateve dhe të fituesve, ruhen në një dosje të veçantë në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.

18. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë.

19. Të gjitha rregullat e parashikuara në akte nënligjore të nxjerra nga Ministri, përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe që janë në kundërshtim me parashikimet e tij, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir Xhafaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 27.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë